

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË " Makishti " SH.P.K.

Sot, me datë 25/07/2022

Z. Neki Makishti, shtetas Shqiptar, lindur më 02/03/1971 në Sohodoll, Shqiperi, mbajtës I kartes se Id me nr. 036097575 , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Makishti** Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**Makishti**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën Tirane, Vaqarr, Zona kadastrale 712, nr i pasurise 10/34

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvèç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *Tregti me pakice e me shumice fruta dhe perime. Import-eksport te frutave dhe perimeve, Tregti mishi, kofsha pule. Shperndarje te mallrave te ndryshem industrial, ushqimore, veshmbathjeetj. Transporti I te gjitha llojeve te skrapit, import, eksport. Hapje bar-restorante, hoteleri, diskoteke dhe qendra estetike. Tregti me pakice te te gjitha llojeve te*



karburanteve. Punime te montimit te rrjetave elektrike te prodhimit dhe te transmetimit te energjise, rrjetave elektrike te objekteve industrial, radiofoni, citofoni etj. Import eksport, tregtim I mallrave industrial dhe ushqimore me shumice dhe pakice si dhe prodhimi I tyre ne vend. Tregtim pije, konfeksiione hidrosanitare, tregtim pllaka shtrimi te llojeve te ndryshme hidraulike, bime medicinale, eterovajore, pajisje elektrike, elektronike, elektroshtepiak, Kinkaleri zyre e shkollore, makineri, pjese kembimi per automjete, bateri, goma etj. Krijimi I serviseve per automjete, lavazhe, tregtim vajrash si dhe sherbim per te gjitha llojet e makinave. Krijimi dhe hapja e agjensive turistike, agjenci informative etj. Transport I mallrave dhe pasagjereve brenda dhe jashte vendit. Punime dhei, sisteme, tarracie terenesh, Ndertime civile industriale turistike buqesore, etj.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërbolini dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 20.000.000 Lek dhe është i ndarë në 1 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Neki Makishti** zoteron 1 kuotë, me 100 % të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 20.000.000 Lek dhe 20.000.000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributave të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisacionin në fuqi.



- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z.Neki Makishti**, e cila zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe italiane.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z. Neki Makishti**, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. **H 1030 21699**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Z.Neki Makishti

Neki Makishti

